

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Seanca plenare

Nr. 02-53/14-07

Prishtinë, më 31 maj, 1 dhe 4 qershor 2007

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

**PROCESVERBAL**

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë.

**Kryetari** konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 82 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

**REND DITE**

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 10 e 11 majit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e kryeministrit, Agim Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin civil,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrat e statusit civil, nr. 46/2004,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor,
8. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për punën njëvjeçare 2006,
9. Debat për Rininë në Kosovë,
10. Debat lidhur me ndryshimin e tarifave dhe të politikave në sektorin e energjisë,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës,
12. Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari e Zhvillim Rural për formimin e Këshillit të Ujërave,
13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me Projektligjin për ndërmjetësim,

14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me Raportin e Komisionit të Pavarur për Media,
15. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës,
16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për energji,
17. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
18. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe Komisionit Legjislativ lidhur me Projektligjin për adoptimin e Konventës së Këshillit të Evropës për krimin në fushën e kibernetikës.

Në fillim të seancës, **kryetari** i njoftoi deputetët e pranishëm se Kryesia e Kuvendit, në bazë të rregullave 6 dhe 23 të Rregullores së punës së Kuvendit, e ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme. Në ndërkohë, asnjë grup parlamentar nuk ka parashtruar ndonjë mocion me shkrim për plotësimin e tij.

Deputetja **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, kërkoi që pika e 10-të të shtyhet për mbledhjen e radhës, me arsyetim se deputetëve u është shpërndarë një material shtesë me vonesë. Deputetët nuk kanë pasur kohë ta shqyrtojnë këtë material.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e kryetares së Grupit Parlamentar të ORA-s. Por, Kuvendi nuk e miratoi kërkesën e saj.

Deputeti **Fehmi Mujota** e informoi Kuvendit për dëmet e mëdha që ishin shkaktuar nga fatkeqësia e natyrorës në komunën e Shtërpçës. Ai kërkoi që Kuvendi ta formojë një Komision ad hoc për t'i ofruar ndihmë komunës së Shtërpçës.

## 2. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 10 e 11 majit 2007

Procesverbali i seancës plenare të 10 e 11 majit 2007 u miratua pa vërejtje.

## 3. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Gazmend Muhaxheri** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me shpenzimin e mjeteve për pagimin e qirasë për banorët e shpërngulur nga fshati Hade.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Muhaxheri.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtrroi një pyetje kryeministrit të Kosovës për mosshpalljen e Ligjit për minierat.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputetja **Qibrije Hoxha** i parashtrroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me Parkun Nacional të Maleve të Sharrit..

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hoxha.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtrroi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve lidhur me trajtimin e kompleksit “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Ministri **Astrit Haraqija** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kelmendi.

Deputeti **Ibush Jonuzi** i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenie Sociale lidhur me trajtimin e invalidëve civilë të luftës (1941-1945).

Ministri **Ibrahim Selmanaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Jonuzi.

Deputeti **Behxhet Brajshori** i parashtrroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me trajtimin e ujërave të zeza në Liqenin e Batllavës.

Ministri **Ardian Gjini** iu përgjigj pyetjes së deputetes Brajshori.

Deputeti **Hajredin Hyseni** i parashtrroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenie Sociale lidhur me pensionin e familjes së dëshmorit Hasan Ramadani

Ministri **Ibrahim Selmanaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit Hyseni.

Deputeti **Ramadan Kelmendi** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës për mosdeklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetit Kelmendi.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** i parashtrroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë lidhur me suksesin dhe sigurinë në mjediset shkollore.

Ministri **Agim Veliu** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hoxha.

Deputetja **Nurishahe Hulaj** i parashtrroi pyetje kryeministrit të Kosovës lidhur me procedimin e Ligjit për ushqimin.

Kryeministri **Agim Çeku** iu përgjigj pyetjes së deputetes Hulaj.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtrroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me mbrojtjen e vendkalimeve të hekurudhës në komunën e Ferizajt.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtrroi pyetje ministrit të Transportit dhe të Postë Telekomunikacionit lidhur me shpenzimet e kripës për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve në komunën e Besianës.

Ministri **Qemajl Ahmeti** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me ndërtimin e një objekti për hemodializë në komunën e Ferizajt.

Ministri **Sadik Idriz** iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhemajli.

### **3. Interpelanca e kryeministrit, Agim Çeku, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s**

**Kryetari** i informoi deputetët për procedimin e kërkesës së Grupit Parlamentar të ORA-s dhe për përgjigjen e kryeministrit, si dhe për kohëzgjatjen e debatit.

Deputeti **Bajrush Xhemajli** tha se Grupi Parlamentar i PDK-së nuk pajtohet me kohën e ndarë për diskutim.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e parashtruesit të interpelancës ta marrë fjalën.

Deputetja **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, e arsyetoi kërkesën për ta ftuar kryeministrin e Kosovës në interpelancë lidhur me caktimin e anëtarëve të bordeve në ndërmarrjet publike.

Qeveria është deklaruar se një prej prioriteteve të saj do të jetë zhvillimi i ekonomisë së vendit -slogani me tri E. Faktor i rëndësishëm, që mund të ndikojë në zhvillim ekonomik të Kosovës janë edhe ndërmarrjet publike. Ato meritojnë kujdes në kritere për përzgjedhjen e udhëheqësve në resurset humane, ku do të përzgjidhen ekspertë me eksperiencë. Është e rëndësishme qasja në përzgjedhjen e udhëheqësve të këtyre ndërmarrjeve dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve nëpër borde të këtyre ndërmarrjeve.

Nga lista të cilën e ka propozuar Qeveria për anëtarët e këtyre ndërmarrjeve aq të rëndësishme për ekonominë e Kosovës, fatkeqësisht nuk mund të konkludojmë ndërlidhjen në mes të emrave të propozuar dhe prioritetit për zhvillim ekonomik. Nëpër borde janë caktuar nënkryetarët e partive, kryeshefat, kryetarët e komunave, aktivistë partiakë. Kjo nuk do të ishte aq problem po që se ata njerëz do të kishin aftësi profesionale.

Prandaj, mund të konkludojmë se të jesh anëtar i Bordit është një dhuratë për aktivistët partiakë. Prej 15 anëtarëve që ia ka propozuar Qeveria AKM-së për miratim, 7 prej tyre janë refuzuar.

Z. kryeministër, a e ndieni përgjegjësinë dhe si e shpjegoni që prej 15 anëtarëve të propozuar 7 janë refuzuar nga AKM-ja?

**Kryetari** e ftoi kryeministrin e Kosovës ta marrë fjalën.

Kryeministri Agim Çeku – Bordi i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit është kompetent dhe përgjegjës për emërimin e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike. Qeveria ka vetëm të drejtën e propozimit, por fjalën e fundit e ka AKM-ja. Përbërja e anëtarëve të Bordit të ndërmarrjeve publike, mënyra e përzgjedhjes së tyre dhe kualifikimet që kandidatët duhet të prezantojnë përcaktohen me rregulloret e brendshme të AKM-së.

Rregulloret e brendshme të AKM-së janë shumë të thjeshta për sa u përket kualifikimeve të anëtarëve të Bordit të ndërmarrjeve publike. Këta duhet të kenë disa vite përvojë në fushën në të cilën ndërmarrja publike vepron ose duhet të kenë ushtruar për disa vjet një profesion i cili është relevant për veprimtarinë e ndërmarrjes publike. Të tjera kritere nuk ka.

Nuk ka asnjë pengesë juridike që një person i cili i plotëson kriteret profesionale, të përcaktuara me rregullore të brendshme të AKM-së, të jetë njëkohësisht edhe anëtar i Qeverisë, Kuvendit, Presidencës apo partisë politike.

Nga kandidatët që i kanë propozuar Qeveria, Bordi i AKM-së disa i ka pranuar dhe disa jo. Nuk janë refuzuar për shkak se janë persona politikë, por për arsye se Bordi ka konsideruar se nuk i plotësojnë kriteret profesionale.

Ndërmarrjet publike nuk janë thjeshtë ndërmarrje afariste, që kanë për qëllim të krijojnë profit, por janë ndërmarrje që kryejnë edhe shërbime publike dhe që janë në funksion të politikave ekonomike, sociale dhe zhvillimore të Qeverisë.

Për shkak të funksionimit publik që kanë ndërmarrjet publike në çdo vend të botës shteti, përkatësisht Qeveria ushtrojnë mbikëqyrje mbi to, në rend të parë duke shkarkuar drejtorët e pasuksesshëm, por këto kompetenca nuk i ka Qeveria e Kosovës. E vetmja mënyrë për të ndikuar sadopak në vendimet dhe veprimet e ndërmarrjeve publike dhe për të ditur se çka po ndodh brenda tyre është që Qeverinë t'i ketë përfaqësuesit e vet në bordet e këtyre ndërmarrjeve.

Qeveria, përveç kriterit profesional, merr parasysh edhe marrëveshjen midis partive që përbëjnë Qeverinë.

Mandati i anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike është i përkohshëm dhe përfundon më 31 dhjetor të këtij viti. Deri atëherë do ta kemi ligjin tonë për ndërmarrjet publike që do ta përcaktojnë qeverisjen e korporatave dhe të ndërmarrjeve publike.

Pas fjalës së kryeministrit Çeku, **kryetari** e hapi debatin.

Në emër të grupeve parlamentare diskutuan: **Alush Gashi** në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së **Bajrush Xhemajli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s **Nazim Jashari**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së **Besa Gaxheri** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 plus **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Hydajet Hyseni**, **Naser Osmani**, **Hatixhe Hoxha**, **Gani Koci**, **Ramadan Kelmendi**, **Fehmi Mujota**, **Hetem Çeku**, **Behxhet Brajshori**, **Hajredin Kuçi** dhe **Sala Berisha-Shala**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit, në emër të parashtresit të mocionit, deputeti **Veton Surroi** tha se përgjigja e kryeministrit sot ndaj interpelancës sonë ishte e pakënaqshme dhe e pamjaftueshme.

Kryeministri, më 26 shkurt të këtij viti ka kërkuar nga partitë, që formojnë koalicionin qeveritar, të japin propozimet e veta për bordet mbikëqyrëse. Kryeministri ka marrë përgjigje nga partitë dhe i ka përcjellë më tutje në AKM.

Kryeministri duhet të ketë më shumë kompetencë se sa postieri.

Problemi i dytë, ku ekziston dallimi konceptual është ai i politikës apo i partizimit. Nuk bën të ketë automatizëm partiak në përzgjedhjen e anëtarëve të bordit, sepse përzgjedhja automatike partiake në borde i partizon ndërmarrjet publike.

Problemi është i qasjes ndaj bordit. Qeveria në ato ndërmarrje publike delegon njerëz, që nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm profesional.

Qeveria duhet të sanksionohet për shkak të një papërgjegjësie të këtyre.



**Kryetari** dha pauzë për drekë.

Pas pauzës seancën e kryesoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

#### **4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për vlerësimin e ndikimit në mjedis**

**Kryesuesi** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Mjedisit dhe i Planifikimit Hapësinor, z. **Ethem Çeku**, në emër të Qeverisë së Kosovës tha se, pas konsultimeve me kryetarët e grupeve parlamentare, e tërheq Projektligjin për vlerësimin e ndikimit në mjedis për ta plotësuar.

#### **5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për statusin civil**

**Kryesuesi** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja e Shërbimeve Publike, **Melihate Tërmkollli**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për normimin e kësaj fushe me ligj të ri.

Në vazhdim ministrja **Tërmkollli** arsyetoi materien e radhitur në nëntë kapituj dhe 66 nene, objektivat, strukturën e Projektligjit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij Projektligji nga ministrja **Tërmkollli**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë në emër të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, **Selvije Halimi**; në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nekibe Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-**Nerxhivane Dauti**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ymer Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Shpresa Murati**.

Në diskutim morën pjesë edhe këta deputetë: **Fetah Berisha, Nexhat Rexha dhe Milazim Haliti**, që i janë bashkangjitur trasnkriptitit.

Në fund, ministrja **Tërmkollli** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 64;

Kundër----- 0.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, njëzëri e miratoi në parim Projektligjin për statusin civil.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

## 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil, nr. 46/2004

**Kryesuesi** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministrja e Shërbimeve Publike, **Melihate Tërmkoll**i, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Regjistrat e Statusit Civil, nr. 46/2004

Në vazhdim ministrja **Tërmkoll**i arsyetoi materien e radhitur në 44 nene, objektivat, strukturën e Projektligjit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministrja **Tërmkoll**i, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë në emër të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media, **Ymer Halimi**; në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Nekibe Kelmendi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-**Hajredin Hyseni**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ymer Halimi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Mahir Yacilar**.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 61;

Kundër----- 1.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për regjistrat e statusit civil, nr. 2004/46.

Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

## 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor, nr. 2004/1

**Kryesuesi** e ftoi propozuesin ta arsyetonte këtë projektligj para deputetëve të Kuvendit.

Ministri i Transportit, Postës dhe Telekomunikacionit, **z. Qemajl Ahmeti**, në emër të Qeverisë së Kosovës e arsyetoi para deputetëve të Kuvendit nevojën për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor.

Në vazhdim ministri **Ahmeti** arsyetoi materien, objektivat, strukturën e Projektligjit, si dhe mënyrën e zbatimit të tij.

Pas arsyetimit të këtij projektligji nga ministri **Ahmeti**, kryesuesi e hapi diskutimin për shqyrtimin e tij në parim.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë projektligj dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Ibush Jonuzi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK- **Hatixhe Hoxha**, emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Xhevdet Neziraj**, në emër të Grupit Parlamentar 6 Plus, **Mahir Yacilar** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Milazim Haliti**.

Pas këtyre diskutimeve, **kryesuesi** e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati ishte si vijon:

Për----- 61;  
Kundër----- 0.

**Kryesuesi konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, njëzëri, e miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për transportin rrugor, nr. 2004/1. Kuvendi i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion - Komision Raportues - për ta shqyrtuar këtë projektligj brenda dy muajve dhe për t'ia paraqitur Kuvendit raportin me rekomandime.

## 8. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për punën njëvjeçare 2006

**Kryesuesi** e ftoi kryeministrin e Kosovës ta arsyetonte Raportin e punës së Qeverisë për vitin 2006.

Kryeministri **Agim Çeku**, - Fushat kryesore që është angazhuar Qeveria e Kosovës për vitin 2006 kanë qenë: përmbushja e standardeve, parapërgatitja për marrjen e kompetencave nga UNMIK-u, zhvillimi ekonomik i vendit, ofrimi i shërbimeve më cilësore për qytetarët, në fushën e arsimit, shëndetësisë, forcimi i rendit dhe i ligjit, qeverisja e mirë, integrimi i minoriteteve në jetën e përditshme dhe në institucionet tona, agjenda e integrimi me evropiane, bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar i Kosovës.

**Zbatimi i standardeve** ka qenë një nga prioritetet kryesore në agjendën e Qeverisë, gjatë vitit 2006 janë paraqitur 4 raporte nga PSSP, para Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të cilat janë vlerësuar shumë lart.

Gjatë vitit 2006 Grupi i Kontaktit e ka ngarkuar Qeverinë e Kosovës dhe Kosovën në tërësi dhe me 13 pika shtesë, të cilat janë kryer të gjitha me sukses dhe në afatin e përcaktuar.

**Zhvillimit ekonomik** i Kosovës gjatë vitit 2006 ka shënuar rritje. Skenari më pesimist është 3% kurse ai më optimist është 5%, janë këto të dhëna nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Buxheti i Kosovës është i qëndrueshëm dhe llogaridhënës që konsiderohet si më i miri në rajon.

Është arritur një rritje e konsiderueshme e të vjelurave të pagesave tatimore, kështu që kemi një rritje afër 70 milion më shumë se sa është paraparë në vitin 2006.

**Privatizimi** ka ecur me ritmin dhe dinamikën e duhur. Kemi nënshkruar disa marrëveshje të tregtisë së lirë dhe disa marrëveshje në fusha të tjera, kemi nënshkruar edhe Marrëveshjen e Cefës dhe kështu Kosova është bërë pjesë e një tregu rajonal.

**Sektori i energjisë** ka qenë një ndër sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar Qeveria e Kosovës dhe Kosova në përgjithësi. Qeveria ka bërë përpjekje të vazhdueshme që të gjejë përgjigje që si të rregullohet situata në sektorin e energjisë dhe mu për këtë i kemi hartuar planin dhe strategjinë e sektorit të energjisë.



Në **fushën e arsimit** gjatë kësaj periudhe sektori qeveritar i arsimit ka mbështetur fuqishëm procesin e reformimit të arsimit të lartë në Universitetin e Prishtinës. Janë mbajtur zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin e Prishtinës dhe është zgjedhur rektori i ri. Kemi dhënë bursa për studentë që studiojnë jashtë vendit, është hartuar strategjia e arsimit parauniversitar 2007 – 2017, kemi themeluar Agjencinë e Akreditimit, janë ndërtuar shkolla të reja me hapësirë prej 4500 m<sup>2</sup>.

Në **fushën e sundimit të ligjit** me krijimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe të asaj të Punëve të Brendshme Qeveria ka plotësuar boshllëkun ekzekutiv për ngritjen institucionale të sundimit të ligjit. Këto dy ministri tashmë janë funksionalizuar dhe në vazhdimsi janë duke ngritur kapacitetet e tyre të nevojshme.

Në funksion të ndërtimit të një shoqërie demokratike në Kosovë, **qeverisja e mirë** vazhdon të mbetet një ndër prioritetet e Qeverisë. Praktikrat e funksionimit demokratik të institucioneve, të drejtat e njeriut, sundimi i ligjit, luftimi dhe parandalimi i korrupsionit dhe i krimit të organizuar kanë vazhduar të mbeten prioritetet e punës së Qeverisë.

**Agjenda e integritit evropian** ka qenë një ndër fushat ku Qeveria është angazhua në veçanti. Është themeluar dhe funksionon Agjencia për Integritet Evropian, pranë zyrës së Kryeministrit.

Gjatë vitit 2006, janë mbajtur 4 takime të Mekanizmit Përcjellës të Stabilizim Asocimit dhe është konstatuar progres i vazhdueshëm në përafrimin e Kosovës me Unionin Evropian.

Qeveria gjatë vitit 2006 ka dhënë kontribut të madh në **procesin e definimit të statusit**, kemi ruajtur dhe forcuar unitetin, stabilitetin politik dhe institucional, besimin institucional si dhe partneritetin me bashkësinë ndërkombëtare.

Kosova në fund të vitit 2006 ka më shumë miq dhe përkrahës se në fillim të vitit.

Qeveria ka rritur dinamikën e punës, transparencën, përgjegjësinë, i ka ngritur kapacitetet dhe është e përgatitur për sfidat e pas statusit.

Pas fjalimit të kryeministrit, kryesuesi e hapi debatin për raportin e punës së Qeverisë për vitin 2006.

**Në emër të grupeve parlamentare diskutuan:** Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Safete Hadërgjonaj**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Gjylnaze Sylja**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, **Veton Surroi**, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Besa Gaxherri** dhe në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, **Xhezair Murati**, si dhe deputetët: **Zahrije Jusufi**, **Naser Osmani** dhe **Afrim Arziullxhiu**.

Deputeti **Gani Koci** propozoi që seanca e sotme t'i ndërpresë punimet për t'i vazhduar nesër.

Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Koci. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----57;

Kundër-----11.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën e sotme.

E premte, 1 qershor 2007

## Vazhdim i seancës

Në fillim të seancës ishin të pranishëm 70 deputetë.

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Vazhdoi debati për Raportin e punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2006.

Në fillim të seancës një numër i deputetëve e kundërshtoi kufizimin e kohës për të debatuar për Raportin e punës së Qeverisë së Kosovës për vitin 2006.

**Kryetari** tha se do të vazhdohet me debatin pa u kufizuar në kohën e caktuar më parë.

Në debat morën pjesë këta deputetë: **Berat Luizha, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Behxhet Brajshori, Sala Berisha-Shala, Hatixhe Hoxha, Ibush Jonuzi, Xhelal Canziba, Zylfije Hundozi, Gani Koci, Nazim Jashari, Hydajet Hyseni, Ramadan Kelmendi, Naim MalokuXhavit Haliti, Zef Morina, Ferid Agani, Bislim Hoti, Nafije Berisha, Xhevdet Neziraj, Lutfi Zharku, Melihate Tërmkoli, Gjergj Dedaj dhe Selvije Halimi**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Në fund të debatit ministrat: **Haki Shatri, Ardian Gjini, Ethem Çeku, Jonuz Salihaj dhe Astrit Haraqija** iu përgjigjen vërejtjeve të deputetëve.

Kryeministri **Agim Çeku** i falënderoi deputetët e Kuvendit për kontributin e dhënë gjatë këtij debati. Vërejtjet dhe sugjerimet e deputetëve, shtoi kryeministri, Qeveria e Kosovës do t'i marrë parasysh gjatë punës vijuese.

Kryesuesi dha pauzë për drekë.

## 9. Debat për Rininë në Kosovë

Deputeti **Enver Hoxhaj**, në emër të propozuesit të mocionit, kërkoi që debati për Rininë në Kosovë të shtyhet për të hënë.

Ministri **Astrit Haraqija** deklaroi se të hënë nuk mund të jetë i pranishëm në seancë. Kryesuesi e hodhi në votim propozimin e deputetit Hoxhaj. Rezultati i votimit ishte si vijon;

Për-----shumica;

Kundër----- 6.

**Kryesuesi** konstatoi se debati për Rininë në Kosovë shtyhet për seancën e radhës.

## 10. Debat lidhur me ndryshimin e tarifave dhe të politikave në sektorin e energjisë

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e parashtruesit të mocionit ta marrë fjalën.

Deputetja **Teuta Sahatqija**, në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s, e arsyetoi kërkesën për të debatuar lidhur me ndryshimin e tarifave dhe të politikave në sektorin e energjisë.

Në vazhdim deputetja Sahatqija më hollësisht i paraqiti shqetësimet lidhur me ngritjen e tarifave për rrymën elektrike, si dhe për politikat e Qeverisë në sektorin e energjetikës.

Në fund, ajo në emër të Grupit Parlamentar të ORA-s i propozojë këto

### REKOMANDIME

- Qytetarët ta paguajnë rrymën,
- Zyra e Rregullatorit të Energjisë të mos bie nën ndikim të interesave individuale, të ndërmarrjeve ose të Qeverisë, por vendimet t'i marrë pas një analize të pavarur dhe profesionale,
- Qeveria t'i orientojë politikat në sektorin e energjetikës në bazë të politikave të veta zhvillimore, e jo politika dhe strategjia zhvillimore t'u përshtaten politikave dhe strategjisë së energjetikës,
- MEM të vërë si përparësi interesin e qytetarëve dhe të shtetit të ardhshëm të Kosovës, në vend të shitjes së tërë pasurisë së Kosovës,
- Kuvendi i Kosovës të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë ku parashihet TCC të ketë fuqinë 1000 e jo 2100 megavat dhe që investimi të jetë i përbashkët e jo ekskluzivisht privat edhe i huaj.

**Kryetari** e ftoi ministrin e Energjetikës dhe të Minierave ta marrë fjalën.

Ministri **Ethem Çeku** - Me strategjinë e miratuar në këtë Kuvend janë përcaktuar të gjitha fazat e zhvillimit të sektorit energjetik, të cilët ne si Ministri dhe si komitet drejtues të këtij projekti jemi të ngarkuar t'i zbatojmë. Me të parashihet që gjatë periudhës 2005 – 2015 duhet të ndërtohen kapacitete të reja gjeneruese deri 1800 megavat. Përmirësimi i sektorit të energjisë, modernizimi i rrjetit, rritja e ofiçencës dhe deri në 2012 krijimi i qendrave rajonale, sanimi i pasojave të krijuara nga termocentralet ekzistuese.

Në vazhdim ministri Çeku i shpjegoi në hollësi politikat e Qeverisë, përkatësisht të ministrisë së energjetikës dhe të Minierave lidhur me ndryshimin e tarifave të rrymës elektrike dhe të politikave në sektorin e energjetikës.

Strategjia e Kosovës për Energjinë për periudhën 2005-2015 identifikon shfrytëzimin racional të linjitet, si një nga burimet kryesore të të ardhurave ekonomike e financiare për mbështetjen e zhvillimit të shpejtë në periudhën afatmesme. Qeveria ka caktuar tri shtylla për mbështetjen e zhvillimit të Kosovës, që janë Ekonomia, Edukimi dhe Energjia, të shprehura me sintagmën "3E".

Energjia është prioritet i kësaj Qeverie.

Në periudhën e ardhshme nuk mund të garantohet furnizimi me importe.

Strategjia e energjisë së Kosovës rekomandon këto veprime:

- ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese,
- avancimin e kapaciteteve ekzistuese të gjenerimit,
- zgjerimin e minierave të linjitet,
- aktivizimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Ministria e Energjisë dhe e Minierave po bënë përgatitjen e strategjisë së Kosovës për sektorin e minierave, që parashikohet të përfundohet mjaft shpejtë. MEM mendon se politika e licencave për eksplorim dhe shfrytëzim të linjitet dhe burimeve të tjera minerare duhet të jetë e tillë që të mundësojë maksimizim të të ardhurave për Kosovën.

Ristrukturimi i sektorit energjetik po kryhet në përputhje me Strategjinë për energji të Kosovës 2005 -2015 me ligjet në fuqi për sektorin e energjisë dhe me vendimet e Qeverisë për këtë qëllim.

MEM kërkon një mbështetje më të madhe nga të gjitha forcat politike në kuadër të Kuvendit të Kosovës.

Diversifikimi i burimeve energjetike dhe shfrytëzimi i atyre të ripërtërishme (dielli, era, uji) të shoqëruar edhe me rritjen e eficiencës në përdorimin e energjisë është një tjetër objektivi i rëndësishëm i punës së MEM.

MEM së bashku me Komitetin Drejtues janë të përkushtuar t'i zbatojnë politikat e aprovuara nga Kuvendi i Kosovës, që qytetarëve dhe bizneseve t'u sigurojë furnizim të rregullt me energji elektrike.

**Kryetari** e hapi debatin lidhur me ndryshimin e tarifave dhe të politikave në sektorin e energjisë.

**Në emër të grupeve parlamentare diskutuan:** Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së **Alush Gashi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Bajrush Xhemajli**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Naim Maloku**, në emër të Grupit Parlamentar 6 plus, **Husnija Beshkoviq** dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Ramadan Kelmendi**, si dhe deputetët: **Gani Koci**, **Ibush Jonuzi**, **Besa Gaxheri**, **Nazim Jashari**, **Ymer Halimi**, **Ragip Zekolli**, **Zylfije Hundozi**, **Fatmire Mulhaxha-Kollçaku**, **Afrim Arzuallxhiu**, **Milazim Haliti**, **Hatixhe Hoxha**, **Behxhet Brajshori**, dhe **Vezira Emrush**, që i janë bashkangjitur transkriptit.

Ministri **Ethem Çeku** iu përgjigj vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve.

Në fund të debatit, **Teuta Sahatqija** në emër të parashtruesit të mocionit, tha se për asnjë dilemë, të cilën e kishin pasur më parë, lidhur me ndryshimin e tarifave dhe të politikave në sektorin e energjisë, ministri i Energjetikës dhe i Minierave nuk ofroi zgjidhje adekuate.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën e sotme në orën 18:20 minuta.

E hënë, 4 qershor 2007

**Vazhdim i seancës**

Në fillim të seancës ishin të pranishëm 63 deputetë.

Seancën e kryesoi **Kolë Berisha**, kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Gazmend Muhaxheri**, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

## **11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri për emërimin e anëtarëve të Komisionit të Konkurrencës**

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Ekonomi, Tregti dhe Industri t'i arsyetonte rekomandimet para deputetëve të Kuvendit.

**Ibush Jonuzi**, kryetar i Komisionit, shpjegoi procedurat e shqyrtimit dhe të intervistimit të kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës. Qeveria e Kosovës Kuvendit ia kishte propozuar dhjetë kandidatë, kurse Komisioni, në pajtim me nenin 25 të Ligjit për konkurrencën, pas intervistimit të tyre, Kuvendit ia propozon pesë kandidatë, si vijon;

1. Remzije Hajdari, juriste e diplomuar,
2. Mustafë Hasani, ekonomist i diplomuar,
3. Denis Jonuzi, ekonomist i diplomuar,
4. Hysni Treziu, ekonomist i diplomuar dhe
5. Hydajet Hyseni, jurist i diplomuar.

**Kryetari** i hodhi në votim, një nga një, kandidatët e propozuar.

Pas përfundimit të procedurave të votimit, **kryetari konstatoi**: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

### **V E N D I M**

1. Kuvendi i Kosovës nuk e miratoi Rekomandimin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion për emërimin e kandidatëve për anëtarë të Komisionit të Konkurrencës.
2. Kërkohet nga Qeveria e Kosovës ta përgatisë dhe Kuvendit t'ia paraqes një listë të re me kandidatë të tjerë në pajtim me nenin 25.3 të Ligjit për konkurrencën, nr. 2004/36.

## **12. Shqyrtimi i Propozimit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari e Zhvillim Rural për formimin e Këshillit të Ujërave**

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim hapësinor ta arsyetonte propozimin para deputetëve të Kuvendit.

**Rifat Krasniq**, kryetar i Komisionit e arsyetoi propozimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Ujërave.

**Kryetari** i hodhi në votim, një nga një, kandidatët e propozuar për anëtarë të Këshillit të Ujërave.

Pas përfundimit të procedurave të votimit, **kryetari konstatoi**: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë



## V E N D I M

1. Anëtarë të Këshillit të Ujërave të Kosovës emërohen:

1. Ali Shala, kryetar,
2. Abdullah Nishori, anëtar,
3. Figena Ahmeti, anëtare,
4. Selvete Hoxha-Krasniqi, anëtare,
5. Vahdet Pruthi, anëtar,
6. Ymer Havolli, anëtar dhe
7. Haxhi Millaku, anëtar.

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit të Ujërave zgjat pesë (5) vjet.

### **13. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me Projektligjin për ndërmjetësim**

**Kuvendi**, pasi e shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë lidhur me procedimin e Projektligjit për ndërmjetësim, mori këtë

## V E N D I M

1. Projektligji për ndërmjetësim i kthehet për ripunim propozuesit – Qeverisë së Kosovës.

### **14. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me Raportin e Komisionit të Pavarur për Media**

**Kuvendi**, pasi e shqyrtoi Rekomandimin e Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media lidhur me Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave, mori këtë

## V E N D I M

1. Kuvendi i Kosovës miraton Raportin vjetor të Komisionit të Pavarur të Mediave për vitin 2006.

### **15. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës**

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese ta arsyetonte rekomandimin para deputetëve të Kuvendit.

**Hydajet Hyseni**, kryetar i Komisionit e arsyetoi rekomandimin për emërimin e anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Ai i paraqiti emrat e kandidatëve të propozuar dhe kërkoi të votohet për secilin veç e veç dhe Kuvendi të marrë vendim me shumicë të thjeshtë.

**Kryetari** i hodhi në votim, një nga një, kandidatët e propozuar për anëtarë të Këshillit të Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Pas përfundimit të procedurave të votimit, kryetari konstatoi: Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

## V E N D I M

1. Anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës emërohen:

1. Vedat Gashi, anëtar,
2. Zait Xhemajli, anëtar,
3. Raima Elezi, anëtar,
4. Vesel Latifi, anëtar,
5. Elmaze Syka, anëtar,
6. Slllobodan Stefanoviq, anëtar,
7. Destan Rukiqi, anëtar dhe
8. Agim Krasniqi, anëtar.

2. Kuvendi i Kosovës nuk e përkrah kandidaturën e z. Hilimi Zhitija për anëtarë të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe kërkon nga Prokuroria Publike e Kosovës që ta propozojë një kandidat tjetër.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës zgjatë dy vjet.

### **16. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për energji**

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ta arsyetonte rekomandimin para deputetëve të Kuvendit.

**Ibush Jonuzi**, kryetar i Komisionit e arsyetoi rekomandimin lidhur me procedimin e Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për energjinë.

**Kryetari** e hodhi në votim rekomandimin e KGJLKK. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----48;

Kundër----- 3.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

## V E N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për energji i kthehet propozuesit – Qeverisë së Kosovës për rihartim në pajtim me kërkesat dhe me standardet e UE-së.

### **17. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion lidhur me Projektligjin për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Rregullatorin e energjisë**

**Kryetari** e ftoi përfaqësuesin e Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion ta arsyetonte rekomandimin para deputetëve të Kuvendit.

**Ibush Jonuzi**, kryetar i Komisionit e arsyetoi rekomandimin lidhur me procedimin e Projektligjit për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për rregullatorin e energjisë.

Kryetari e hodhi në votim rekomandimin e KGJLKK. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----53;  
Kundër----- 5.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, mori këtë

## V E N D I M

1. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Rregullatorin e energjisë i kthehet propozuesit – Qeverisë së Kosovës për rihartim në pajtim me kërkesat dhe me standardet e UE-së.

### **18. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe Komisionit Legjislativ lidhur me Projektligjin për adaptimin e Konventës së Këshillit të Evropës për krimin në fushën e kibernetikës**

**Kryetari** i ftoi përfaqësuesit e komisioneve t'i arsyetonin rekomandimet.

Kryetari i Komisionit për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, **Ibush Jonuzi** dhe nënkryetari i Komisionit Legjislativ, **Sadudin Berisha**, i arsyetuan para deputetëve të Kuvendit rekomandimet e komisioneve lidhur me procedimin e Projektligjin për adaptimin e Konventës së Këshillit të Evropës kundër krimit në fushën e kibernetikës.

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e komisioneve. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për-----63;  
Kundër----- 5.

**Kryetari konstatoi:** Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, vendosi që Projektligjin për adaptimin e Konventës së Këshillit të Evropës kundër krimin në fushën e kibernetikës t'ia kthejë Qeverisë së Kosovës për rihartim, si dhe nxori këtë

## **REZOLUTË**

1. Kuvendi i Kosovës i përkrah parimet e Konventës së Këshillit të Evropës kundër krimin në fushën e kibernetikës.
2. Qeveria e Kosovës të iniciojë negociata me Këshillin e Evropës për arritjen e marrëveshjes për ratifikimin e Konventës kundër krimin në fushën e kibernetikës.
3. Qeveria e Kosovës, në afatin prej 90 ditësh, Kuvendit duhet t'ia paraqesë Projektligjin kundër krimin në fushën e kibernetikës, në pajtim me parimet e Konventës së Këshillit të Evropës kundër krimin në fushën e kibernetikës dhe të konkluzioneve të Samitit të Selanikut për shoqëritë informative dt.01 korrik 2005.

**Kryetari e deklaroi seancën të mbyllur në orën 12:10 minuta.**

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Kolë BERISHA**

---

E hartoi

**Sektori i Çështjeve Plenare dhe Procedurale**